

POLICY BRIEF

Transferimi dhe menaxhimi i pronës shtetërore në Bashkinë Tiranë

Sfida dhe perspektiva

Arlind LUGJI

2016

Ky publikim është përgatitur me mbështetjen e Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA), në kuadër të programit drejtuar alumnëve të Shkollës Shqiptare të Studimeve Politike me titull "Përdorimi efikas i hulumtimit dhe advokimit mundëson politika më të mira evropiane në nivel lokal në Shqipëri".

Përmbajtja e këtij publikimi nuk pasqyrojnë opinionin zyrtar të Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë. Përgjegjësia për informacionin dhe pikëpamjet e shprehura në publikim i përket autorëve.

Procesi i transferimit dhe menaxhimit të pronës shtetërore

Ndryshimet kushtetuese të vitit 1998 u hapën qeverive vendore rrugë të reja për të kaluar nga statusi i *përdoruesit* në atë të *pronarit* të pronave shtetërore. Procesi i përcaktimit të tokës dhe pronave shtetërore dhe ndarja e tyre në mes të agjencive shtetërore dhe njërive të qeverisjes vendore (NJQV) është një proces i cili ka nisur që nga viti 2001. Procesi i transferimit të pronës shtetërore rregullohet në bazë të Ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar dhe Ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar.

Ky proces është menaxhuar nga Agjencia Shtetërore për Transferimin e Pronave Publike, e cila përcakton standardet dhe mbikëqyr punën e qeverive vendore dhe administratës vendore. Teorikisht procesi përfshin një fazë fillestare, në të cilën administrata e bashkisë duhet të inventarizojë truallin shtetëror dhe objektet e paluajtshme brenda territorit të saj si dhe të caktojë ato për të cilat ajo kërkon transferimin. Lista më tej qarkullon midis agjencive shtetërore. Kur arrihet një marrëveshje, ajo miratohet me vendim nga Këshilli i Ministrave në një formë paraprake dhe shfaqet publikisht nga njësi vendore për 90 ditë. Pas publikimit dhe ndonjë korrigjimi, Këshilli i Ministrave jep miratimin përfundimtar të transferimeve në bashki dhe caktimin e pronave të agjencive shtetërore. Faza përfundimtare është regjistrimi në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP).

Një ndër mangësitë e ndeshura nga autoritetet vendore gjatë inventarizimit të pronës shtetërore konsiston në pamundësinë e sigurimit të informacionit të saktë nga ZRPP.

Kjo e fundit nuk garantonte gjendjen juridike të pronësisë përpara përfundimit të regjistrimit fillestar dhe futjes së zonave kadastrale në sistem sipas Ligjit Nr.7843, datë 13.07.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”¹. Kjo mangësi e ngadalësoi shpejtësinë e inventarizimit të pronës shtetërore dhe krijoi barrierë të cilat penguan procesin e regjistrimit të saj për shkak të mospërputhjes së të dhënave.

Pronat shtetërore klasifikohen në dy kategori: “prona publike” dhe “prona jopublike të paluajtshme të shtetit”. Sipas ligjit, të parat u referohen pronave shtetërore si bregdeti, zonat historike dhe kulturore si dhe rrugët, urat, hekurudhat dhe parqet, nëse janë në pronësi të shtetit. Të dytat u referohen pronave jopublike si tokat bujqësore, zonat urbane dhe ndërtesat në pronësi të ndërmarrjeve të administruara nga shteti që kanë të drejta ligjore të njëjta me ato të pronave private. *Risia e këtij klasifikimi qëndron në faktin se kategoria e dytë i referohet pronave të “tregtueshme” (prona të zhvillimit ekonomik) që zakonisht materializojnë ambicien e qeverive vendore për të fituar të drejtën e pronësisë apo të përdorimit mbi sa më shumë prona gjatë procesit të transferimit të pronës shtetërore.*

Me transferimin e pronave në kontrollin vendor, menaxhimi i tyre bëhet një përgjegjësi e rëndësishme vendore. NJQV-të kanë të drejtë të shesin tokën për zhvillimin e strehimit social. Ato kanë përgjegjësi për planifikimin urban, menaxhimin e tokës dhe strehimin duke angazhuar fondet e tyre, buxhetin e shtetit, fondet e donatorëve apo të Partneritetit Publik Privat (PPP) për programet e strehimit social, strehimit me kosto të ulët apo për infrastrukturën e tokës.

Pas heqjes së kufizimeve të huamarrjes, përdorimi i PPP shihet si një mundësi e NJQV-ve për financimet private me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe efikasitetit të infrastrukturës publike dhe asetëve vendore. Nga ana tjetër, menaxhimi i duhur i pronës ka shumë rëndësi për menaxhimin e mirë financiar vendor. Menaxhimi më i mirë i asetëve mund të realizohet përmes opsioneve të ndryshme (qiraja, koncensionë, shitja e pronave), të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë në përmirësimin e shërbimeve publike, duke ulur humbjet dhe kostot e panevojshme operative.

E megjithatë, asnjë nga këto nuk mund të arrihet nëse transferimi i pronës shtetërore do të vonohet dhe/ose nëse pronat e transferuara nuk mund të regjistrohen në ZRPP në pronësi të qeverive vendore.

Për të trajtuar këto nevoja, dhe për të sjellë një rast konkret operimi në nivel vendor, ky hu-

lumtim do t'i kushtojë vëmendje drejtimeve kryesore të mëposhtme në lidhje me procesin e transferimit dhe menaxhimit të pronës shtetërore në Bashkinë Tiranë:

- 1) Identifikimin e statusit të inventarizimit, transferimit dhe regjistrimit të pronave shtetërore drejt njësisë së qeverisjes vendore, Bashkisë Tiranë.
- 2) Të analizojë progresin dhe problematikat e procesit të transferimit dhe regjistrimit të pronave shtetërore.
- 3) Të identifikojë dhe analizojë opsionet e përdorimit dhe menaxhimit të pronës shtetërore nga Bashkia Tiranë.

Në përfundim, do të mundësohen rekomandime konkrete për përmirësimin e mëtejshëm të këtij procesi në Bashkinë e Tiranës, rekomandime këto që mund të vlejné edhe për NJQV të tjera.

Statusi i inventarizimit dhe transferimit të pronës shtetërore tek Bashkia Tiranë: sfida e regjistrimit

Në Shqipëri, arsyeja themelore e transferimit të pronës shtetërore qeverive vendore buron nga delegimi i pronave të domosdoshme për përmbushjen e funksioneve vendore, përfshirë zhvillimin ekonomik² vendor.

Ligji nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar, paraqet rregullat dhe procedurat për regjistrimin e pronave pa bërë dallim midis pronave “publike” dhe “private”. Ligji parashikon që dokumentet që kanë të bëjnë me të drejtat e pronësisë, si për shembull, dokumentet e miratimit të transferimit, të regjistrohen në ZRPP brenda 30 ditësh nga data e miratimit zyrtar. Përtej këtij afati, secila nga palët është e detyruar të paguajë gjobë, pa përjashtuar këtu qeveritë vendore apo institucionet shtetërore. Kostot e regjistrimit për pronat e paluajtshme shkojnë deri në 7 mijë lekë/pronë. Ligji gjithashtu parashikon një kamatë të barabartë me 10% të tarifës së regjistrimit për çdo ditë vonesë, për çdo pronë.


Në bazë të këtij ligji, nevojitet që njësitë vendore të përballojnë kostot e regjistrimit të

pronave të transferuara nëpërmjet të ardhurave të tyre. Megjithëse, në parim, ky vendim është i arsyeshëm dhe shkon paralelisht me nocionin e autonomisë financiare vendore.

Të dhënat e mbledhura për qëllimet e këtij studimi³ tregojné se në Bashkinë Tiranë nuk ka përfunduar ende procesi i inventarizimit të pronës shtetërore. Numri i pronave të inventarizuara deri në shtator 2016 nga Bashkia Tiranë është rreth 13.700 pasuri.⁴ Nga ana tjetër, të dhënat e këtij procesi lidhen ngushtësisht me procesin e regjistrimit fillestar sistematik të pasurive të paluajtshme, proces i cili për disa zona të Bashkisë Tiranë nuk ka përfunduar ende.

Në vitin 2012⁵, Këshilli i Ministrave miratoi listën paraprake të pjesshme (pjesa e parë dhe pjesa e dytë), për rreth 6.200 prona të paluajtshme shtetërore të cilat rekomandohen për transferim në pronësi dhe në përdorim të Bashkisë Tiranë. Ende edhe sot, pas 4 vjetësh, për asnjë nga këto pasuri shtetërore nuk është kryer nga Këshilli i Ministrave transferimi përfundimtar në pronësi apo përdorim të Bashkisë Tiranë. Ndërkohë, rezultojné rreth 7 mijë pasuri të paluajtshme, për të cilat ka përfunduar me sukses faza e inventarizimit⁶, por që nuk është kryer procedura për transferimin paraprak në pronësi apo në përdorim të Bashkisë Tiranë.

Bashkia Tiranë e justifikon vonesën e këtij procesi gjatë këtyre dy viteve të fundit me bllokimin e tij nga Ministria e Punëve të Brendshme, për shkak të zbatimit të reformës territoriale administrative. Duke patur parasysh faktin që ky proces ka nisur që në vitin 2001, shifrat aktuale tregojné për një hezitim nga ana e këtij autoriteti lokal për të ndërmarë procesin e transferimit të pronës shtetërore, ndoshta për shkak të sasisë së madhe të punës që sjell përgatitja dhe dorëzimi i dosjeve.



Grafiku 1 – Ecuria e Procesit të Transferimit të pronës shtetërore në Bashkinë Tiranë

Në pronësi të Bashkisë Tiranë janë transferuar në mënyrë përfundimtare rreth 500 pasuri, nga të cilat vetëm 248 janë regjistruar pranë ZRPP. Meqënëse një pjesë e pasurive shtetërore janë në fazë miratimi të listave paraprake dhe përfundimtare, po bëjmë një analizë të përballeshmërisë së kostos së regjistrimit për këto pasuri nga ana e Bashkisë Tiranë. Janë rreth 13.700 pasuri që potencialisht priten të transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë, duke sjellë kështu të dhëna se cilat janë pasojat e mundshme financiare të këtij transferimi.

Kostot e regjistrimit për të gjitha pronat e transferuara do të konsistonin në 98 milionë Lekë ose afërsisht 1% e të ardhurave vendore të Bashkisë së Tiranës, të parashikuara në planin për vitin 2016⁷.

Pronat që i përkasin kategorisë “prona jopublike të paluajtshme të shtetit”, të quajtura edhe prona të tregtueshme, përbëjnë një potencial të lartë për gjenerimin e të ardhurave dhe ofrimin e shërbimeve publike. Bashkia e Tiranës pritet të fitojë të drejtat përfundimtare të pronësisë mbi 500 prona që mund të përdoren për zhvillimin ekonomik.

Krahas mungesës së kapaciteteve për të mbuluar kostot e regjistrimit, shfaqen pabarazi të mëdha edhe midis vlerave të aseteve të transferuara me potencial për zhvillim ekonomik. Në këtë pikë, nuk mund të presim nga Bashkia Tiranë që të ndajë të njëjtin interes ndaj pronave të transferuara, duke qenë se vlera

e aseteve të marra është e ndryshme. Vlera e mundshme e pronave të transferuara përcakton deri në njëfarë mase interesin e kësaj Bashkie në kryerjen e procesit të transferimit dhe regjistrimit të pronës. Ky komponent nuk merret në konsideratë gjatë procesit.

Sfida pasardhëse për Këshillin vendor është gjenerimi i burimeve financiare për regjistrimin e këtyre pronave në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

Efekti i kostove të regjistrimit të pronave shtetërore për Bashkinë Tiranë, përderisa procesi i transferimit nuk ka përfunduar, ka tendencë rritjeje në kohë, pasi tarifat për regjistrim ndryshojnë si rezultat i ndryshimit të kostove të tregut.

Sfidat e pronave të transferuara “për përdorim”

Si çdo reformë tjetër, procesi i transferimit të pronave drejt qeverive vendore nuk është zhvilluar në vakum. Të drejtat e pronësisë së Bashkisë Tiranë nuk janë mjaftueshmërisht të sigurta dhe kjo përbën një sfidë të rëndësishme për qeverisjen vendore. Reforma të tjera që synonin rishpërndarjen e pronave si privatizimi, dhe procesi i kthimit dhe kompensimit të pronës kishin nisur që në fillimet e viteve ’90. Megjithatë, këto procese u hartuan dhe u zbatuan në mënyrë të pavarur nga njëri-tjetri si dhe pa përfillur efektet dhe eksternalitetet e mundshme të secilit. Siç pritej, ato u zbatuan në një kontekst kaotik dhe janë ende të papërfunduara. Nga ana tjetër, nuk mund të lihet pa përmendur fakti që migrimi i vrullshëm i brendshëm ka çuar në zënie informale të tokës dhe në ndërtime pa leje në një masë të konsiderueshme të territorit të administruar nga Bashkia Tiranë, duke i vështirësuar kështu edhe me tej problemet e lidhura me pronat vendore.

Në kuadër të reformës administrativo-territoriale në Republikën e Shqipërisë, Bashkia Tiranë është subjekti që trashëgon të drejtat e pronësisë për pasuritë e paluajtshme të 13 NJQV (ish komuna), që me ligjin nr. 115/2014 janë shkrirë. Këto të drejta mbeten sërish të cënueshme në kushtet kur në këto njësi vijon procesi i shpërndarjes së akteve të marrjes

së tokës bujqësore dhe kalimit në pronësi të përfituesve të tokës bujqësore.

Procesi i transferimit të pronave shtetërore është veçanërisht i lidhur me procesin e kthimit dhe kompensimit të pronave ish-pronarëve. Pronat shtetërore të përfshira në juridiksionin e Bashkisë Tiranë, të identifikuara si prona për t'u përdorur për kompensimin e ish-pronarëve, ndodhen në një proces transferimi të përkohshëm drejt Bashkisë Tiranë, nën të drejta "përdorim" dhe jo të drejta "pronësie". Ndonëse kjo shifër nuk është shumë e lartë, kjo kategori pronash zotëron potencialin më të madh për zhvillim, duke qenë se shumica e tyre janë truall urban apo toka bujqësore.

Sikurse potenciali i tyre ekonomik, edhe kompleksiteti i zhvillimit të tyre në kushtet aktuale është i lartë. Së pari, kompleksiteti i tyre konsiston në afatin kohor të papërcaktuar për përdorim. Mosnjohja e afatit kohor të përdorimit të pronës ndikon në marrjen e vendimeve strategjike mbi menaxhimin e saj dhe pengon përdorimin efektiv nga Bashkia Tiranë. Së dyti, problem paraqet dhe regjistrimi i këtyre pronave në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme nga autoritetet vendore për shkak të kostove financiare.

Me të drejtë, Bashkia Tiranë nuk angazhohet për të mbuluar kostot e regjistrimit të pronave mbi të cilat nuk ka të drejta pronësie. Veç kësaj, pa regjistruar aktet e transferimit "në përdorim" në ZRPP, njësitë vendore nuk mund t'i shfytëzojnë këto prona as për kontrata qeraje. *Në këto kushte del në pah mungesa e një politike të integruar dhe shumëpërmasore që arrin të mbulojë këto aspekte problematike të transferimit të pronave.* Aktet ligjore ekzistuese nuk përcaktojnë qartë autoritetin përgjegjës për mbulimin e kostove të regjistrimit për pronat e transferuara "në përdorim", duke ua imponuar këtë përgjegjësi njësitë të qeverisjes vendore.

Proceset tranzitore të transferimit, kthimit dhe privatizimit të pronës shtetërore shkaktajnë ndryshime të shpejta dhe masive në permbytjen dhe madhësinë e portofolit të pasurive të paluajtshme shtetërore të inventarizuara nga Bashkia Tiranë.

Së fundmi, për shkak të pengesave dhe konflikteve të pronësisë të sipërpërmendura, pronat e transferuar nën statusin "në përdorim" ndodhen të bllokuara apo "të ngrira" për një afat të papërcaktuar. Në këtë mënyrë kompromentohet zhvillimi dhe mbarështimi i pronës publike duke shkaktuar humbje për shoqërinë në tërësi.

Mundësitë dhe sfidat e Bashkisë Tiranë drejt një sistemi efektiv menaxhimi të pasurive të paluajtshme

Procesi në vazhdim i transferimit të pronës publike tek Bashkia Tiranë, duket sikur po e shtyn këtë autoritet vendor në një pozicion pritës. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se duhen neglizhuar rrugë të tjera të mundshme të shtimit të pronës së paluajtshme dhe rritjes së efektivitetit të sistemit të menaxhimit të pasurive ekzistuese që administrohen nga kjo Bashki.

Menaxhimi efektiv i pasurive vendore për të mirën e komunitetit duhet të përfaqësojë një pjesë të rëndësishme të programit të Bashkisë Tiranë, ndonëse ky autoritet nuk ka ende një dokument (plan) të miratuar për menaxhimin e aseteve të saj të paluajtshme të administruara nga ky autoritet. Ndonëse është autoriteti vendor më i madh dhe kryesor në vend, Bashkia Tiranë rezulton të mos ketë të miratuar një strategji për menaxhimin e pasurive të paluajtshme, pjesë të portofolit të saj, e cila do të merrte në konsideratë objektivat strategjike të çdo njësie administrative pjesë përbërëse të saj, si dhe do përfaqësonte karakteristikat individuale të portofolit të pasurive të paluajtshme që kjo Bashki posedon.

Pranë Bashkisë Tiranë ka një njësi organizative që merret me menaxhimin e aseteve të saj, por me një numër të pamjaftueshëm punonjësish dhe me mungesë kapacitetesh për të përballuar fluksin e punës në raport me portofolin e gjerë dhe kompleks të pasurive që administron kjo Bashki.

Në lidhje me mbajtjen e të dhënave mbi pasuritë e administruara nga Bashkia, këto të fundit janë të kompjuterizuara në lista (hard copy). Të dhënat e regjistruara për pasuritë zakonisht lidhen me karakteristikat e tyre fizike

si sipërfaqe, vendndodhje, etj., dhe gjithnjë e më pak përmbajnë informacion funksional. Kjo për arsye se këto të dhëna nuk përditësohen në mënyrë të rregullt. Aksesimi në të dhënat financiare gjithashtu mbetet i kufizuar.

Përdorimi dhe shfrytëzimi i pasurive të paluajtshme ka një impakt të ulët në situatën financiare të Bashkisë Tiranë. Niveli i të ardhurave të Bashkisë nga qiratë e pasurive të paluajtshme për vitin 2015 ishte në vlerë të papërfillshme në raport me totalin e të ardhurave vjetore të kësaj njësie.

Përveç kontratave të qirasë, vihet re se është kufizuar vetëm në një rast aplikimi i Partneritetit Publik Privat, pavarësisht se është një nga mënyrat më të mira për të mundësuar investimet për shërbimet vendore, si edhe një nga mjetet më efikase për të stimuluar zhvillimin ekonomik vendor.

Nuk ka të dhëna sistematikisht të matshme mbi efikasitetin e përdorimit të pasurive të paluajtshme ose performancën financiare të pa-

surive publike të administruara nga Bashkia Tiranë, duke e bërë të pamundur që të llogaritet përfitueshmëria nga asetet publike. Bashkia Tiranë ndeshet me një pamundësi për t'ju përgjigjur kërkesës për strehim social të qytetarëve të saj, ndërkohë që këto nevoja mund t'i adresojë në një masë të konsiderueshme nga pronat vendore.

Situata e përshkruar deri më tani tregon që menaxhimi i aseteve të paluajtshme nga Bashkia Tiranë nuk është ende i zhvilluar, derisa kjo e fundit përfiton më tepër nga aplikimi i taksave vendore mbi pasurinë e paluajtshme sesa nga zbatimi i programeve afatgjata të përdorimit e shfrytëzimit të pasurive të portofolit të saj. Politikisht, rritja e buxheteve vendore nëpërmjet ngritjes së taksave vendore është një proces shumë delikat krahasuar me rritjen e të ardhurave vendore nëpërmjet një menaxhimi më të mirë të aseteve. Një situatë e tillë përbën një faktor të rëndësishëm për të rivlerësuar qasjen e Bashkisë Tiranë ndaj menaxhimit të pasurive të saj.

REKOMANDIME

Në kuadrin e decentralizimit dhe forcimit të autonomisë vendore, asnjë politikë për transferimin e pronës shtetërore drejt NJQV-ve nuk ka për qëllim të përbëjë një barrë për këto të fundit. Përkundrazi, objektivi final është të krijojë shanse për përmirësimin e shërbimeve publike vendore dhe për zhvillim ekonomik, duke u mundësuar bashkive dhe komunave të drejtat e pronësisë dhe pavarësinë në vendimmarrjet që lidhen me përdorimin e pronës.

Për sa i përket rastit të Bashkisë Tiranë, është e qartë që transferimi i pronës shtetërore është një proces shumë delikat dhe i ndërlikuar. Megjithatë, jemi ende në kohë për të rivlerësuar linjën e procesit dhe për të përcaktuar disa çështje të rëndësishme në agjendën e Bashkisë Tiranë.

Bashkia Tiranë:

■ **Zhvillimi i kapaciteteve dhe rritja e numrit të stafit** për plotësimin e dosjeve me dokumentacionin përkatës me qëllim përfundimin sa më të shpejtë të procesit të transferimit të pronës tek Bashkia Tiranë.

■ Është momenti për të eksploruar dhe hulumtuar mbi mënyra të ndryshme⁸ që promovojnë “çlirimin” e pronave të transferuara në “përdorim”, veçanërisht Bashkia Tiranë dhe palët e tjera të përfshira, si sektori pri-

vat apo pronarët individualë. Pronat “në përdorim” duhet të kapitalizohen nga Bashkia pa frenuar zhvillimin e pronës. Kjo bashki duhet të marrë një **rol më proaktiv dhe të negociojë interesat private dhe publike në të mirë të zhvillimit vendor.**

■ **Ngritja e një databaze të integruar të dhënash** mbi pasuritë e paluajtshme, përmes aplikimit të **një sistemi informacioni GIS** dhe **një sistemi të menaxhimit financiar**, ku të identifikohen të gjitha pasuritë e paluajtshme të administruara nga Bashkia Tiranë.

Kjo do të mundësonte një analizë më të mirë të informacionit mbi pasuritë dhe si rrjedhojë një menaxhim më eficient të pasurive që janë pjesë e portofolit të saj.

■ **Kontraktimi dhe përfshirja e ekspertëve të jashtëm** për çështje specifike të menaxhimit të pronave shtetërore nga Bashkia Tiranë.

■ Hartimi i një **Strategjie për Menaxhimin e Pasurive të Paluajtshme** që administrohen nga Bashkia Tiranë, e cila do të përbente një qasje efektive për përmirësimin e aftësisë së Bashkisë për të arritur qëllimet e saj urbane, mjedisore, sociale dhe ekonomike.

■ Hartimi i një **Plani Menaxhues të Pasurive të Paluajtshme të Bashkisë Tiranë**, i cili do të përcaktojë rregullimet organizative që duhet të ndërmerren për zbatimin e strategjisë dhe do të qartësojë faktorët e suksesit dhe output-et që duhet të arrihen në zbatimin e kësaj strategjie.

■ Për të pasur një riorientim më të përshtatshëm të menaxhimit të pronave vendore, inkurajohet Bashkia Tiranë për **përdorimin e metodave të qëndrueshme të menaxhimit të pronave** si leasing, koncesionet, Partneriteti Publik Privat, si dhe aplikimi i huamarrjes vendore.

■ Nisur nga fakti se konteksti lokal është një faktor shumë i rëndësishëm për planifikimin e menaxhimit të aseteve, rekomandojmë mbajtjen e një **komunikimi të vazhdueshëm me komunitetin**, pasi ky mund të ndihmojë Bashkinë në përcaktimin e prioritetëve dhe niveleve të shërbimit. Qytetarët mund t'i japin Bashkisë një pikëpamje tjetër rreth prioritetëve dhe mënyrës sesi asetet mund të bëhen funksionale dhe të vlefshme për ta.

Ministria Drejtësisë dhe Ministria e Financave:

■ Paraqitet një nevojë urgjente për **ndërrhyrje lidhur me kostot e regjistrimit**, duke qenë se për Bashkinë Tiranë, kostot e regjistrimit përbëjnë rreth 1% të të ardhurave vjetore. Duke qenë se tarifat e regjistrimit kalojnë në buxhetin e shtetit, **qeveria mund të përjashtojë Bashkinë Tiranë** si dhe njësitë e tjera vendore nga ky detyrim. Në të kundërt, deri në sigurimin e të ardhurave të mjaftueshme për përballimin e plotë të këtyre kostove, Bashkia Tiranë mund të aplikojë **politikën e seleksionimit** duke aplikuar vetëm për regjistrimin e pronave që janë transferuar në pronësi të saj, të cilat mund të përdoren për veprimtari ekonomike apo zhvillimi.

Burime

- 1 Ligji në fuqi deri në mars 2012. Shfuqizuar me ligjin 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.
- 2 Ligji nr. 8652 datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i ndryshuar.
- 3 Të dhënat për qëllimet e këtij studimi janë mbledhur nga data 25.07.2016 deri në datën 25.09.2016 dhe konsistojnë kryesisht në të dhëna statistikore.
- 4 Burimi i informacionit pranë Drejtorisë së Aseteve të Bashkisë Tiranë. Studimi i materialeve (prprodukteve) të projektit “PROMISE”.
- 5 VKM nr.143, datë 18.01.2012 “Për miratimin e listës paraprake (pjesa e parë + pjesa e dytë) të pronave të paluajtshme publike shtetërore që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Tiranë, të Qarkut të Tiranës”.
- 6 VKM nr. 650, datë 31.07.2013 “Për miratimin e listës së pjesshme të inventarit (pjesa e tretë, e katërt dhe e pestë) të pronave të paluajtshme shtetërore në Bashkinë Tiranë, të Qarkut të Tiranës”.
- 7 VKB nr. 58, datë 30.12.2015 “Për miratimin e PBA 2016-2018 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2016”.
- 8 RTI International (2007), A Toolkit for Municipal Asset Management, <http://community-wealth.org/sites/clone.community-wealth.org/files/downloads/tool-rti-asset-mgmt.pdf>.